



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 257/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani, dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në Fushë Kosovë, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me dt. 12.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë.

Arsyetim

Me datë 08.06.2014 PZAP-i, ka pranuar një ankesë, nga subjekti politik PDK në të cilën pretendohet se në Fushë Kosovë, në Qendrën e Votimit në shkollën “Mihajl Gameno” personi Misin Zymeri në cilësinë e kryesuesit nga radhët e subjektit politik LDK ka tentuar që të fut nga dy herë militantë të subjektit politik LDK për të votuar. Më tutje ka theksuar se Misin Zymeri në cilësinë e kryesuesit të subjektit politik LDK e ka keqpërdorur detyrën zyrtare sipas nenit 214 të Kodit Penal dhe e ka shkelur nenin 36 parag.1 pika a), b) e LZP-së nr.03/L-073.

Parashtruesi i ankesës ka kërkuar nga PZAP-i që konform legjislacionit të merren masa ndëshkimore ndaj subjektit politik LDK.

Në bazë të nenit 4.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it i njoftoj lidhur me ankesën Anr.257/14 që është ushtruar ndaj subjektit politik LDK, prandaj dhe kërkoj që të përgjigjen në ankesë deri me datë 10.06.2014 deri në ora 10:00.

PZAP-i, ka pranuar përgjigjen në ankesë nga subjekti politik LDK ku theksohet se, pretendimet ankimore në ankesë janë të pa bazuara nga fakti se mungojnë prova bindëse për shkeljet e e bëra.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Nga pretendimet ankimore të cekura nuk mund të vërtetohet ajo për të cilin pretendon pala ankuese në ankesën e saj, pasi që nuk është ofruar asnjë provë si

dëshmi, qoftë ndonjë deklaratë apo provë tjetër që do të vërtetonte shkeljen. Prandaj një pretendim i tillë ankimor është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu vërtetuar dhe se për këtë arsye ankesa në fjalë u vlerësua si e pa bazuar, sipas nenit 3.6 pika c) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it si dhe në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 257/2014 më datën 12.06.2014

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda një-etekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*